

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 SPORTIT DHE RINISË
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2021
 ME ZGJEDHJE – SESIONI I

Qershor 2021

Ora 10:00

Lënda: Histori HB

VARIANTI A

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

1. Për 20 pyetjet me zgjedhje (alternativa), pasi të keni qarkuar alternativën e saktë në test, duhet të mbushni rrathët përkatës të tabelës në fletëpërgjigje.

Lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna në fletëpërgjigje.

2. Për pyetjet me zhvillim përgjigjet duhet të shkruhen brenda zonës së kufizuar me vijë. Çdo përgjigje e shkruar jashtë vijave kufizuese, nuk do të vlerësohet.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	4	5	10	17	18	19	27
Pikët							
Kërkesa	28	29	30	31	32	33	34
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

1. "Për herë të parë të gjithë qytetarët e lirë burra mund të votonin dhe të zgjidheshin". Këto reforma u ndërmorën në Greqinë e lashtë nga: **1 pikë**

- A) Drakoni;
- B) Likurgu;
- C) Klisteni;
- D) Soloni.

2. Cili ishte fisi ilir që mori drejtimin e shtetit ilir pas enkelejdëve? **1 pikë**

- A) Thesprotët.
- B) Taulantët.
- C) Parthinët.
- D) Ardianët.

3. Cili nga pohimet e mëposhtme është pasojë e sundimit romak në Iliri? **1 pikë**

- A) Përkrahu shtetin e Epirit në konfliktin me Maqedoninë.
- B) U zhvillua më shumë gjuha dhe kultura ilire.
- C) Ndarja e Ilirisë në katër provinca.
- D) Zgjerimi territorial i Ilirisë.

4. Cilat janë fazat nëpër të cilat kaloi shteti i Epirit dhe kur e arriti ai kulmin e zhvillimit të tij? **2 pikë**

5. Në Romën antike, plebenjtë edhe pse përbënin shumicën e popullsisë, nuk merrnin pjesë në qeverisjen e vendit. Kërkesat e tyre për të fituar të drejta qeverisëse ishin të vazhdueshme. Shpjegoni ecurinë e përfaqësimit të plebenjve në kuadër të institucioneve romake. **2 pikë**

6. Nëpërmjet Kartës së Madhe të Lirive (Magna Karta) në Angli u arrit: **1 pikë**

- A) t'i jepej fund luftës 100 vjeçare me Francën;
- B) të kufizohej sovraniteti mbretëror dhe fuqia e tij;
- C) të forcohej roli i mbretit lidhur me sistemin e taksave;
- D) të rrëzohej sovraniteti mbretëror, duke sjellë republikën.

7. Pse popullsia e Ilirisë së Jugut nuk u asimilua nga sllavët? 1 pikë
- A) Popullsia e Ilirisë së Jugut mori ndihma ushtarake nga Perandoria Bizantine.
B) Sllavët nuk kishin leje nga perandorët bizantinë për të hyrë në Ilirinë e Jugut.
C) Sllavët nuk arritën dot në Ilirinë e Jugut, pasi patën rezistencë të fortë në Ilirinë e Veriut.
D) Iliria e Jugut ishte më e zhvilluar, me popullsi më të dendur dhe me fortifikime më të shumta.
8. Cila prej principatave të mëposhtme shënoi bashkimin e parë politik të një pjesë të konsiderueshme të trevave arbërore në periudhën mesjetare? 1 pikë
- A) Principata e Balshajve.
B) Principata e Arianitëve.
C) Principata e Topiajve.
D) Principata e Arbrit.
9. Në cilin vend lindi besimi protestant? 1 pikë
- A) Itali.
B) Spanjë.
C) Holandë.
D) Gjermani.
10. Jepni dy nga shkaqet e Skizmës (Ndarjes) së Madhe të besimit të krishterë. 2 pikë
- _____
- _____
- _____
- _____
11. Pretekst për fillimin e konfliktit midis anglezeve dhe kolonistëve shërbeu: 1 pikë
- A) taksa e pullës;
B) zgjerimi i territorit të kolonive;
C) guvernatorët e zgjedhur nga Anglia;
D) shfrytëzimi ekonomik i kolonive nga Anglia.
12. Çfarë rruge ndoqi Bismarku në procesin e bashkimit të Gjermanisë? 1 pikë
- A) Realizoi një marrëveshje aleance me Francën.
B) Përdori luftën si mjet në procesin e bashkimit.
C) Përdori referendumet në territoret e banuara nga gjermanët.
D) Hyri në konflikt me Rusinë, për të mos e patur më si kërcënim në të ardhmen.
13. Me cilin prej shteteve të mëposhtme, shteti i Skënderbeut ka patur marrëdhënie të luhatura? 1 pikë
- A) Me Republikën e Venedikut.
B) Me Republikën e Raguzës.
C) Me Mbretërinë e Napolit.
D) Me shtetin Papal.

14. Perse italianët ishin të pakënaqur në përfundim të Luftës I Botërore? 1 pikë

- A) Nuk ishin shpërblyer mjaftueshëm nga Konferenca e Paqes.
- B) Monarkia me dinastinë Savoia ishte rrëzuar.
- C) Në pushtet kishte ardhur Partia Komuniste.
- D) Italia ishte konsideruar shtet humbës.

15. Një nga pasojat e krizës ekonomike të viteve 1929-1933 në SHBA ishte: 1 pikë

- A) Rimëkëmbja ekonomike e Evropës;
- B) Rënia e bursës së Nju Jorkut;
- C) Rritja e çmimit të aksioneve;
- D) Humbja e vendeve të punës.

16. Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, në Evropë u formuan dy blloqe politike, ekonomike dhe ushtarake të kundërta. Kjo situatë u reflektua në: 1 pikë

- A) ndërprerjen totale të marrëdhënieve tregtare midis Evropës Lindore dhe Evropës Perëndimore;
- B) hedhjen poshtë të Planit Marshall nga ana e Bllokut Perëndimor;
- C) fitoren e forcave komuniste në luftën civile në Greqi;
- D) ndarjen e Gjermanisë dhe ndërtimin e Murit të Berlinit.

17. Duke krahasuar pashallëqet e Janinës dhe të Shkodrës, jepni dy të përbashkëta dhe një të veçantë në organizimin dhe funksionimin e tyre. 3 pikë

Dy të përbashkëtat:

E veçanta:

18. Listoni tri nga arsyet përse Anglia u bë atdheu i Revolucionit të Parë Industrial: 3 pikë

19. Çfarë kuptonte "bllokada kontinentale" e shpallur nga Napoleon Bonaparti? Cila ishte arsyeja e kësaj bllokade? **3 pikë**

Kuptimi i "bllokadës kontinentale":

Arsyeja:

20. "Shteti i Mirëqenies Sociale" ishte një program ekonomik që u zbatua pas Luftës së Dytë Botërore, fillimisht në: **1 pikë**

- A) Britaninë e Madhe;
- B) Gjermani;
- C) Francë;
- D) Austri.

21. Në cilin nga shtetet e Bllokut Lindor lëvizja antikomuniste mori forma të rezistencës së armatosur kundër sovjetikëve? **1 pikë**

- A) Çekosllovakia.
- B) Hungari.
- C) Poloni.
- D) RDGJ.

22. Cilit prej presidentëve të SHBA-së i takon Kursi i Neokonservatorizmit? **1 pikë**

- A) Xh. Karterit.
- B) Xh. Bushit.
- C) R. Reganit.
- D) L. Xhonsnit.

23. Gorbaçov me reformat e tij synonte: **1 pikë**

- A) ndryshimin e sistemit politiko-ekonomik;
- B) një politikë të ashpër ndaj Bllokut Perëndimor;
- C) një reformim pa ndryshuar sistemin ekzistues;
- D) shpërbërjen e BS dhe krijimin e shteteve të pavarura.

24. Cili ishte statusi që fitoi Shqipëria pas pushtimit të saj nga Gjermania naziste? **1 pikë**

- A) Sovranitet i plotë.
- B) Sovranitet relativ.
- C) Sovranitet i derivuar.
- D) Sovranitet i pakushtëzuar.

25. Cili ishte mekanizmi ekonomik në Jugosllavi pas viteve '50, të shek. XX?

1 pikë

- A) Ekonomi e planifikuar dhe e centralizuar.
- B) Vetëadministrim socialist.
- C) Ekonomi sociale e tregut.
- D) Ekonomi e tregut të lirë.

26. Konferenca e Tiranës e vitit 1956 është një ngjarje e rëndësishme në historinë e regjimit komunist në Shqipëri sepse:

1 pikë

- A) Enver Hoxha u propozua në postin e kryeministrit;
- B) u zhvilluan kritika të forta drejtuar udhëheqjes;
- C) u hodh ideja e kolektivizimit të bujqësisë;
- D) u miratua plani i dytë pesëvjeçar.

27. Organizata e Kombeve të Bashkuara është një organizëm shumë i rëndësishëm.

a) Kur u krijua kjo organizatë?

1 pikë

b) Cili ishte dokumenti, parimet e të cilit shërbyen si bazë për krijimin e OKB?

1 pikë

c) Cili ishte synimi i krijimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara?

1 pikë

28. Jepni tre rrugë që u përdorën për krijimin e bazës ekonomike të sistemit socialist në Shqipëri.

3 pikë

29. Statusi politiko-juridik i Kosovës në kuadër të Jugosllavisë ka pësuar disa ndryshime sipas situatave dhe kushteve historike apo përpjekjeve të shqiptarëve për afirmimin e të drejtave të tyre kombëtare.

a) Evidentoni statusin që fitoi Kosova fill pas Luftës së Dytë Botërore. **1 pikë**

b) Çfarë ndryshimi ndodhi me miratimin e kushtetutës së vitit 1974 lidhur me statusin e Kosovës? **1 pikë**

c) Cila ishte kërkesa kryesore në protestat e popullsisë shqiptare të vitit 1981? **1 pikë**

30. Evidentoni tre prej masave që mori kryeministrja e Britanisë së Madhe, Margaret Theçer në zbatim të programit të saj ekonomik. **3 pikë**

31. Konferenca e Jaltës, e mbajtur 4-11 shkurt 1945, ishte një ngjarje e rëndësishme, ku rolin kryesor e luajtën tre të mëdhenjtë Ruzvelti, Çerçilli, Stalini.
Cilat ishin vendimet e marra në këtë Konferencë? **3 pikë**

32. Traktati i Bashkimit Evropian (i njohur si Traktati i Mاستrihtit) është një nga gurët e themelit në procesin e integritimit evropian.

Identifikoni tre shtyllat që përbëjnë strukturën e këtij traktati.

3 pikë

33. Në gjysmën e dytë të viteve '80, të shekullit XX, kriza e regjimit komunist në Shqipëri, u bë gjithnjë e më shumë e pranishme, pavarësisht përpjekjeve për tejkalimin e saj. Një ndër to ishte edhe zbatimi i një paketë masash ekonomike që u njohën si "mekanizmi i ri ekonomik".

Cilat ishin tri prej masave që përmbante kjo paketë?

3 pikë

34. Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, dy superfuqitë luftuan për të krijuar epërsi ndaj njëra-tjetrës. Shpjegoni në cilat aspekte u shfaq konfrontimi midis tyre.

4 pikë
